

NJOFTIM PËR KONTRATË

 PUNË FURNIZIM SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 04.09.2024

Nr i Prokurimit	631-24-7807-5-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN		
Adresa Postare: MENTOR TOLAJ		
Qyteti: DEÇAN	Kodi postar: 51000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Xhevdet Ramosaj	Telefoni: 03820044319,03820044333	
Email: prokurimi.decan@rks-gov.net	Faksi:	
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kk.rks-gov.net/decan/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Ndërtimi i Pishinës gjysëm olimpike Deçan

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input checked="" type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input checked="" type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Deçan

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Kontrate publike kornizë me disa operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Ndërtimi i Pishinës gjysëm olimpike Deçan

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45000000-7

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po Jo

Nëse *po*, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: **2,076,704.77**

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Sipas Specifikimit Teknik

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **36** apo ditë (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse *po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10% e vlerës së kontratës për fituesin e tenderit, për periudhën 37 muaj** % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L 068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.(Obligative për të gjithë OE 2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se OE i ka kryer obligimet tatimore ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit deri në tremujorin e fundit .(për fituesin e tenderit) 3.Vërtetim nga Gjykata Ekonomike- që nuk është në procedurë gjyqësore ose i dënuar më parë për vepër penale.(për fituesin e tenderit)	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit , duke përdorur formën në Ankesin 2 2.Vërtetim nga ATK-ja se nuk është në vonesë, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit. 3.Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike.(Original).
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2. Certifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Evidenca 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje). Evidenca 2. Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 3,500,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, ku lideri duhet të ketë 60% të vlerës. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet te ketë kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhironlogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 300.000,00 euro ose financim te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet financimi.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1. Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. Dëshmia 2. Deklaratë nga banka apo Letër Reference që dëshmon se OE mund të mbështetet nga Banka për këtë projekt, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga institucioni
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme punë ndërtimore në 3(tri) vitet e fundit. Në një vlerë prej jo më pak se 3,000,000.00€.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1. Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke plotësuar Aneksin i cili është në DT duke saktësuar punët e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të punëve – (referencë ose raport të pranimit të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat

	atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkuara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.
Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (Njëzet) punëtorë të jenë të certifikuar për punë të sigurt në vendin e punës dhe së paku 10 prej tyre të trajnuar për mbrojtje nga zjarri nga një kompani e certifikuar nga institucionet shtetërore. Një (1) punëtor të certifikuar si murator. Një (1) punëtor të certifikuar për sistem të drenazhimit dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si ne vijim. Një (1) punëtor të certifikuar Molerues. Një (1) punëtor të certifikuar Ngruhje Ftohje kondicionim. Një (1) punëtor të certifikuar Pllakashtrues. Një (1) punëtor të certifikuar Hidorinstalues. Një (1) punëtor të certifikuar Saldues. Një (1) punëtor të certifikuar Elektrik. Një (1) punëtor të certifikuar për punë në lartësi PMI.	Dëshmia 2. Lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani e nënshkuar dhe Vulosur nga kompania, si dhe certifikatat e noterizuar për punë të sigurt në vendin e punës dhe për mbrotje nga zjarri . Poashtu licenca e kompanisë e cila ka kryer trajnimet kopje e noterizume. Për muratorin duhet dorëzuar Certifikatën e noterizuar nga vete punëtori së bashku me Kontratën e Punës e noterizuar. . Për drenazherin duhet dorëzuar Certifikatën e noterizuar së bashku me Kontratën e Punës e noterizuar. Vërejtje! Në rast se Operatori Ekonomik nuk posedon përbërjen e stafit punëtorët e lartcekur atëherë mund të angazhoj staf për këtë projekt (me kohëzgjatje të projektit dhe emër të projektit)– si dëshmi të prezantoj një Kontratë të punës të nënshkuar dhe noterizuar në mes dy palëve.
Kërkesa 3. a.) Një (1) inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë -drejtimi konstruktiv së paku 3(Tri) vite përvojë pune pas diplomimit menaxher i projektit të jetë i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe të jetë i certifikuar për menaxhim të kantierit të ndërtimit.	Dëshmia 3. Për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi vendimi për caktimin e projekt menaxherin, e nënshkuar dhe vulosur nga kompania, CV e nënshkuar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar nga inxhinieri), Referencat për punët e ngjajshmetë lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3(Tri) vite përvojë punës pas diplomimit. Certifikatat e noterizuara. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar në mes dy palëve) .
Kërkesa 4. b.)Një(1) inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë-drejtimi-hidro së paku 3(Tri) vite përvojë pune pas diplomimit Udhëheqës i punishtës në teren, të jetë i trajnuar si ekspert për siguri dhe shëndet dhe Mbrotje nga Zjarri nga AME.	Dëshmia 4. Për Udhëheqësin e punishtës në teren duhet të ofrohet vendimi për caktimin e Udhëheqësin së punishtës, CV e nënshkuar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar nga inxhinieri) , Referencat për punët e mëparshme në lëmin e ngjajshme të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3(Tri) vite përvojë punës pas diplomimit. Certifikatat e noterizuara. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar në mes dy palëve)
Kërkesa 5. c.) Një (1) Inxhinier i diplomuar ose master i inxhinierisë (elektrike) drejtimi elektroenergjetik me 3(Tri) vite përvojë pune pas diplomimit të jetë auditor i efijencës në objekte dhe ndriçim publik .	Dëshmia 5. CV e nënshkuar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar). Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3(Tri) vite përvojë punës pas diplomimit. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar) , certifikatat kopje të noterizuara nga vetë inxhinieri
Kërkesa 6. Një (1) Inxhiniera I Gjeodezisë apo master i gjeodezisë së paku 3(Tri) vite përvojë	Dëshmia 6. CV e nënshkuar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar). , Licenca e punës (e

<p>pune pas diplomimit duhet të jetë i licencuar.</p>	<p>noterizuar), Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3(Tri) vite përvoje pune pas diplomimit. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar) .</p>
<p>Kërkesa 7. Një (1) inxhinier i diplomuar apo master i Makineris , me së paku 3 vite përvoje pune pas diplomimit i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS dhe Mbrojtje nga Zjarri nga AME.</p>	<p>Dëshmia 7. CV e nënshkruar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar) , Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3(tre) vite përvoje punës pas diplomimit. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar), certifikatat kopje të noterizuara nga vetë inxhinieri.</p>
<p>Kërkesa 8. Një(1) inxhinier i diplomuar apo master i arkitektures së paku 3 vite përvoje pune pas diplomimit auditorë i eficiencës dhe i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS .</p>	<p>Dëshmia 8. CV e nënshkruar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar) , Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3 vite përvoje punës pas diplomimit. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar) , certifikatat kopje të noterizuara nga vetë inxhinieri</p>
<p>Kërkesa 9. Një(1) inxhinier i diplomuar apo master i i Mbrojtjes se mjedisit 3 vite përvoje pune pas diplomimit i certifikuar për siguri dhe shëndet nga MPMS dhe mbrojtje nga zjarri nga AME . Të jetë i licencuar për hartimin e raporteve të VNM-së</p>	<p>Dëshmia 9. CV e nënshkruar nga inxhinieri, Diploma (e noterizuar) , Referencat për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon 3 vite përvoje punës pas diplomimit. Kontrata e punës me punëdhënësin valide (kopje e noterizuar) , certifikatat kopje të noterizuara nga vetë inxhinieri</p>
<p>Kërkesa 10. 14.Stafi Teknik 14.1- Një (1) teknik i ndërtimitaris me 3 vite përvoje pune 14.2-Një teknik e arkitekturës me 3 vite përvoje pune 14.3-Një teknik i elektrikës me 2 vite përvoje pune 14.4-Një teknik i makinerisë me 2 vite përvoje pune 14.5-Një teknik i hidrondërtimit me 2 vite përvoje pune</p>	<p>Dëshmia 10. Për teknikët të prezantohen diplomat kopje të noterizuara nga vet teknik, CV, Kontrata e noterizuar . Për teknikë të prezantohen trajnimet për siguri dhe shëndet në punë dhe Mbrojtje nga Zjarri Dëshmia Vërejtje! Në rast se Operatori Ekonomik nuk posedon përbërjen e stafit punëtorët e lartcekur atëherë mund të angazhoj staf për këtë projekt (me kohëzgjatje të projektit dhe emër të projektit)– si dëshmi të prezantoj një Kontratë të punës të nënshkruar dhe noterizuar në mes dy palëve.</p>
<p>Kërkesa 11. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë a.) 1(një) Luge Ngarkuese b.) 1(një) Ekskavatorë (makineri me strukturë rrotulluese) mbi 20t c.) 1(një) Ekskavatorë (makineri me strukturë rrotulluese deri 4t ç.) 1(një) Ekskavatorë (makineri me strukturë rrotulluese deri 3.5 t d.) 2(dy) kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë bartëse mbi 10 t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), dh.) 2(dy) kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë bartëse deri 10 t (kamionët duhet të kenë certifikatë të</p>	<p>Dëshmia 11. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi deklaratat unike doganore ose kontrata apo fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzim, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim për këtë projekt (me kohëzgjatje të projektit dhe emër të projektit), kopje të librezave mbi pronësinë e tyre (me validitet të regjistrimit) ose DUD – i doganor, ose fatura e blerjes Lista e</p>

<p>regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), e.) 1(një) gjysëmrimorkio per bartjen e automjeteve te rënda me pesh bartëse minimum 18t maksimumi 24 t (gjysëmrimorkio duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), ë.) 1(një) Makinë ngjeshëse rule - cilindër me peshe deri 12t f.) 3(tre) Kamion auto mikser (kamioni duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), g.) 1 (një) Auto pompë për beton(auto pompa duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), h.) 1(një) Pijuner me pesh totale 5t deri 7 t i.) 1 (një) Kompresori i ajrit me rrota për tërheqje mbi 1000kg(kompresori duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), j.) Pajisje ndërtimore për kallupim të betonit – pajisjet skele per punet e betonit që perdoren per ndërtim. k.) 2 (dy) Papuqe vibruese (pllakë vibruese) l.) 1 (një) Damper të tonazhit të mesëm me peshë totale 2t deri 3t ll.) 2 (dy) Kompaktues betoni vibrator m.) 1(një) Pajisje për matjen e sasisë së betonit n.) 1(një) Makinë ngjeshës i dheut rule me peshe 1000kg deri 1400kg. nj) 1(një) Makinë për suvatim o) 1(një) makinë për mgjyrosje p) 1(një) makinë për grryerje gleti q) WC për punishte r) Skelero min. 1500 m² rr) Panele metalike per betonim min. 300 m² s) Rrethoja metalike min. 300 copë sh) 1(një) Automjet special me vinç, pesha e automjetit 50t deri 60t, pesha ngritëse duhet të jetë 240t deri 250t. t.) 1(një) Kamiona me konstrukcion ndërtim kiper me kran peshë maksimale e ngarkesës 7t deri 8 t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), th.) 1(një) Kamionë me korpë me peshë totale automjetit deri 4t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit),</p>	<p>pajisjeve duhet te jete e noterizuar nga Noteri. Vërejtje! Në rast se Operatori Ekonomik nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen mbi qiramarrjen ku ajo duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit .</p>
<p>Kërkesa 12. Operatori Ekonomik duhet te ketë bazë për a)prodhimin e betonit, b) licence shfrytëzimi rërë dhe zhavor c)Licence për Administrimin e Mbeturinave</p>	<p>Dëshmia 12. Kopjet e noterizuar e licencave te vlefshme te lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale dhe Lejet mjedisore nga MMPH për pikat a, b, si dhe Licenca për administrimin e mbeturinave valide. Vërejtje! Ne rast se OE nuk posedon licencë, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e Operatorit Ekonomik. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit ne emër të projektit me kohëzgjatje deri ne përfundim të projektit.</p>
<p>Kërkesa 13. Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me ISO – ISO 9001 2015- Certifikimi I sistemit për Menagjimin e PASS 99 2012- Sistemi</p>	<p>Dëshmia 13. Dëshmia 3.Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me CERTIFIKATË ISO valide</p>

I Integruar I Menaxhimit – ISO 14001 2015- Sistemi I Menaxhimit Mjedisor. ISO 28001 2007 Sistemi Për Menaxhimit e Sigurisë në zingjirin e furnizimit. ISO 45001 2018- Sistemi Për Menaxhimit e Sigurisë dhe shëndetit në punë	
Kërkesa 14. Raporti I Vlerësimi te riskut nga një kompani e licencuar nga MPMS për siguri dhe shëndet ne pune	Dëshmia 14. Kopje e noterizuar për Raportin e Vlerësimi te riskut si dhe licenca e lëshuar nga MPMS kopje e noterizuar

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</p> <p><i>Nëse po</i>, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse</p>
<p>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

<p>IV.1.1) Lloji i procedurës</p>
<p><input checked="" type="checkbox"/> E hapur</p>
<p><input type="checkbox"/> E kufizuar</p>
<p><input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata</p>
<p><input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit</p>
<p>IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (<i>procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:</p>
<p>IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (<i>procedurë konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar</p> <p>Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>
<p>IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:</p>
<p>IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik</p>

Do te përdoret ankandi elektronik: Po Jo

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

- Çmimi më i ulët
ose
 Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po Jo

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i
i

Po Jo

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranimit të tenderëve / aplikacioneve:

data 25.09.2024 koha 14:00:00 vendi Tenderët duhet te dorëzohen vetem ne mënyrë elektronike përmes Platformës Elektronike E-Prokurimi

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

Po Jo

***Nëse po,* jep arsyetim Për shkak se sezona dimërore po afrohet dhe punët ndertimore duhet të jenë në kushte të përshtatshme klimatike si dhe mjetet financiare janë përkrahje buxhetore nga Institucionet Qendrore përkatesisht Ministria e Kultures Rinisë dhe Sportit.**

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **30,000.00 Euro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** apo muajt

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **90** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data **25.09.2024** koha **14:00:00** vendi **Zyra e Prokurimit-Deçan**

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)